



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit




1 U vra mbrëmë, flet babai i 25-vjeçarit: U largua nga shtëpia për të pirë kafe, nuk dlinim të kishte konflikte!

Priste të ikte në Gjermani tek i vëllai



2 Mustafa Nano: A kanë gra këta njerëz?



3 Vrasja në Vlorë, 25 vjeçari s'e priste që ta qëllonin, deri në vendin e krimit u shogërua nga persona të njohur



4 Ministri i Jashtëm italian: Afganistani nuk mund të bëhet terren për terrorizmin



5 Aksidentohen 3 makina në Kurbin, 3 të plagosur rëndë, dërgohen në spitalin e Traumës



Aktualitet

Shkoi me pistoletë në brez për të ndihmuar shokun në një sherr, arrestohet një 37-vjeçar! Parandalohet një vrasje e mundshme në Sarandë

Ndërhyrja në kohë e policisë ka parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti pasi 37-vjeçari ishte thirrur për ndihmë nga një shok i tij për ta ndihmuar pas sherri, verbal e më pas fizik, me një 19-vjeçar.



Arma e sekuestruar



Redaksia

12 Gusht, 11:30 | Përditësimi i fundit: 12 Gusht, 11:32



SARANDË-Krist Çakalli, 37-vjeç, është arrestuar në Sarandë pasi është kapur nga uniformat blu teksa lëvizte me armë zjarri pistoletë me vete. Ndërhyrja në kohë e policisë ka parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti pasi 37-vjeçari ishte thirrur për ndihmë nga një shok i tij për ta ndihmuar pas sherri, verbal e më pas fizik, me një 19-vjeçar.

"Nga hetimet e shpejta paraprake rezultoi se shtetasi H. F., që punonte roje në një subjekt, ishte konfliktuar verbalisht e më pas fizikisht, për motive të dobëta, me një 19-vjeçar. Pasi janë dërguar në spital, për mjekim, në ambientet e jashtme të spitalit është afruar shtetasi K. Ç., i cili ishte thirrur nga shtetasi H. F., për të vijuar konfliktin.

Falë informacioneve të marra në kohë nga Policia se shtetasi K. Ç. kishte shkuar te spitali dhe me vete mbante një armë zjarri pistoletë, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe Forca e Posaçme "Shqiponja", kanë ndërhyrë profesionalisht në kohë, duke bërë të mundur kapjen dhe prangosjen e shtetasit K. Ç., 37 vjeç, banues në Tiranë, i cili kur ka parë shërbimet e Policisë ka tentuar të largohet dhe ka hedhur në tokë armën e zjarrit.

Gjithashtu, në vijim të veprimeve u procedua në gjendje të lirë shtetasi H. F., 58 vjeç, banues në Sarandë, për veprën penale "Dëmtime të tjera me dashje" ndaj 19-vjeçarit N. P", ka njoftuar policia e Sarandës, e cila ka bërë me dije se ka kaluar materialet procedurale në drejtim të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.



LEXO EDHE:

Sherr me thika mes dy adoleshentëve në Sarandë, plagoset me thikë 16-vjeçari

K.T./Shqiptarja.com

TAG:

vlore

armembajtje pa leje

konflikt

sarande

krist cakalli



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Jeni pro apo kundër strehimit të afganëve në Shqipëri?

Po

Jo

S'kam mendim

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet



Aksidentohen 3 makina në Kurbin, 3 të plagosur rëndë, dërgohen në spitalin e Traumës

21 Gusht, 20:52

Aktualitet



Zjarr në Qerret të Kavajës, digjen kullota

21 Gusht, 20:36

Aktualitet



Afganë në Qytetin Studenti? Lajmi 'fake' që qarkulloi në portale, janë emigrantë nga Bangladeshi! Për nesër të planifikuara dy fluturime Kabul-Tiranë, por s'janë të sigurta

21 Gusht, 19:40

Aktualitet



Strehimi i afganëve, reagon Rusia: Të gatshëm të ofrojmë shërbime të avionit civil, të evakohen të gjithë qytetarët

21 Gusht, 19:20


Aktualitet



5 mijë raste aktive me COVID-19 në të gjithë vendin, Manastirliu apel për vaksinim: Qendrat e hapura edhe gjatë fundjavës

21 Gusht, 19:10

Aktualitet



Parakalime të gabuara me shpejtësi skëterrë, arrestohen 21 shoferë, hiqen 68 patentat! Lumë gjobash në 24 orët e fundit

21 Gusht, 18:01

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju